



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr. BOPP Prot

Shkodër, më 07.06.2026

Lënda: DËRGOHET PËR SHQYRTIM RELACIONI DHE PROJEKT VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR NË BASHKINË SHKODËR”

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin “Për Miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit Për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Shkodër”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Me respekt,

KRYETAR

Benet BECI

Me vendim delegim:

ZV/KRYETAR

Rudin Beka





REPUBLIKA E SHQIPËRSË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 13098/1 prot.

Shkodër, më 03.06.2026

PROJEKT-VENDIM

NR. ____ DATË ____ / ____ / 2026

PER MIRATIMIN E "PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN
PARASHKOLLOR NË BASHKINË SHKODËR"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 8, neni 23 pika 12, neni 54 pika k, Ligjin nr. 69/2018 "Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga administrata e Bashkisë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Shkodër,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Planin e Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë e Shkodrës" sipas dokumentit bashkëlidhur pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës, Arsimit dhe Sportit, Drejtoria e Arsimit sipas strukturës organizative dhe përgjegjësisë së tyre.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet Beci

Me vendim delegimi

ZV/KRYETAR

Rudina Bërra



Drejtoria e Arsimit
Dornateke kalaj

Drejtoria Juridike
[Signature]

Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së
Objekteve Publike

[Signature]

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve
Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

[Signature]

Zy. Kryetar/e
[Signature]
RE-PUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA SHKODER



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E “PLANIT TË PËRMIRËSIMIT TË SHËRBIMIT PËR ARSIMIN PARASHKOLLOR NË BASHKINË SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Është hartuar Plani i Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Shkodër, i cili synon të adresojë sfidat ekzistuese dhe të krijojë baza të forta për zhvillimin e qëndrueshëm të arsimit parashkollor.

Qëllimi i këtij plani është përmirësimi i cilesise së arsimit parashkollor në Bashkinë Shkodër, duke përfshirë zhvillimin e infrastrukturës së kopshteve, forcimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e aksesueshmerise per të gjithë femijët.

Plani fokusohet në proceset e menaxhimit, proceset kryesore dhe proceset mbështetëse të shërbimit, me synim garantimin e një shërbimi gjithëpërfshires, të sigurt dhe cilësor për femijet në kopshtet publike.

Dokumenti gjithashtu përfshin një analize lidhur me vizionin, misionin dhe objektivat strategjike të planit duke përcaktuar gjithashtu personat përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e tij.

Pjesa e dyte dokumentit fokusohet në vendosjen e objektivave specifike për secilin proces dhe përcaktimin e treguesve të performances për t'u përdorur per monitorim.

Plani është shtrirë në të gjitha kopshtet nën juridiksionin Bashkise Shkoder dhe do të monitorohet nga Drejtoria e Arsimit me qëllim përmirësimit të shërbimeve arsimore parashkollore për të gjithë fëmijët në këtë zonë.

Plani i Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Shkodër përqëndrohet në Proceset e Menaxhimit të shërbimit në arsimin parashkollor me qëllim përmirësimit të cilesise dhe organizimit efektiv. Planifikimi dhe kontrolli i cilesise janë thelbesore per kete qëllim, duke përfshirë planifikimin e numrit të femijëve në kopshte dhe vlerësimin e infrastrukturës së

nevojshme. Objektivat kryesore të planit përfshijnë rritjen e regjistrimeve dhe frekuentimit në kopshte të vazave dhe djemve, fuqizimin e strukturave të kopshteve dhe sigurimin e një shperndarje të barabarte të fëmijëve.

Plani i Përmirësimit të Shërbimit synon të adresojë Proceset Kryesore dhe të përmirësojë shërbimin për fëmijet në nevojë për përfshirje sociale, mbrojtje dhe ata me aftësi të kufizuara në kopshtet publike të Bashkisë Shkodër. Qëllimi kryesor është të rritet identifikimi, vlerësimi dhe trajtimi më i mirë i këtyre rasteve në mënyrë që të sigurohet një shërbim cilësor për fëmijët.

Planifikimi dhe zbatimi i Proceseve Mbështetëse në Planin e Përmirësimit të Shërbimit për kopshtet publike të Bashkisë Shkodër ka për qëllim për të siguruar një mjedis të përshtatshëm dhe cilësor për fëmijët. Këto procese janë të rëndësishme për arritjen e qëllimeve të përcaktuara, duke përfshirë trajnimin e stafit, përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve dhe sigurimin e materialeve didaktike.

Qëllimi i Proceseve Mbështetëse është t'i ofrojnë mbështetje për proceset kryesore të shërbimit në kopshte. Këto përfshijnë aspekte të rëndësishme si edukimi, siguria, zhvillimi dhe aksesueshmëria për të gjithë fëmijët.

Për të arritur këtë qëllim, objektivat kryesore përfshijnë plotësimin e standardeve të vendosura nga ligji për stafin e kopshteve, rikonstrukcionin e godinave të kopshteve për të përmirësuar infrastrukturën dhe sigurimin e materialeve didaktike për të përmbushur nevojat e zhvillimit të fëmijëve.

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 8, neni 23 pika 12, neni 54 pika k, Ligjin nr. 69/2018 "Për Sistemin e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, paraqesim projekt vendimin për shqyrtimin dhe miratimin e Planit të Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Shkodër.

Drejtoreshë
Donatela Kalaj



BASHKIA
SHKODËR

**PLANI I ARSIMIT
PARASHKOLLOR (kopshte)**

BASHKIA SHKODËR

2026-2028

Përmbajtja

1.Hyrja	5
Qëllimi.....	5
Shtrirja.....	6
Vizioni.....	6
Misioni	6
Objektivat	6
2.Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	7
Qëllimi.....	7
<i>Objektiva të përgjithshëm</i>	7
Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025	11
Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor	11
Frekuentimi në kopshte dhe gjithëpërfshirja.....	11
Infrastruktura dhe aksesueshmëria.....	12
Planifikimi dhe regjistrimi	14
Përfshirja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve.....	14
Qeverisja dhe strukturat institucionale.....	15
Shërbimi i arsimit sipas njësisve administrative.....	15
Njësia Administrative: Shkodër	15
Njësia Administrative: Ana e Malit	16
Njësia Administrative: Bërdicë	17
Njësia Administrative: Guri i Zi	17
Njësia Administrative: Postrisë	18
Njësia Administrative: Rrethinat	18
Organizmat e Institucionit Arsimor	19
3.Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit.....	21
<i>Qëllimi</i>	21
<i>Objektiva të përgjithshëm</i>	21
Përfshirja sociale	22
Mbrojtja e fëmijëve	22

Fëmijët me aftësi të kufizuar	23
4.Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit	24
<i>Qëllimi</i>	24
<i>Objektiva të përgjithshëm</i>	25
Menaxhimi i godinave.....	25
Materialet	26
Ushqimi	26
Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parashkollor.....	27
<i>Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parashkollor</i>	<i>27</i>
Projektet e Investimeve të Programit	28
Buxheti që mbështet planin për Zhvillimin dhe mbështetjen e arsimit parashkollor për periudhën 2026–2028. Programi AI 141 Arsimi PBA 2026-2028.....	29
Përmbledhje e investimeve (2026–2028).....	29
Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve).....	29
Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit.....	29
Monitorimi dhe vlerësimi	34
Indikatorët e Performancës	34
Planifikimi i vlerësimit të progresit	35
Përfshirja e aktorëve të jashtëm	35
Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi	35
Monitorimi i realizimit të aktiviteteve	35
Vlerësimi i ndikimit në komunitet	36
Rishikimi dhe përshtatja e planit.....	36
Procesi i rishikimit	36
Përshtatja e masave dhe aktiviteteve	37
Raportimi dhe transparenca	37
Të dhëna për kopshtet jo publike	41

Falenderime

Bashkia Shkodër shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit të Arsimit Parashkollor 2026–2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik vendor. Për hartimin e Planit të Arsimit Parashkollor 2026-2028, jemi bazuar edhe në “Planin e Përmirësimit të Shërbimit për Arsimin Parashkollor në Bashkinë Shkodër, të konceptuar nga Znj.Blediana Nika.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë angazhimin e Këshillit Bashkiak të Shkodrës për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë procesit, si dhe për përfshirjen aktive në garantimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe transparente.

Një vlerësim i veçantë shkon për Zyrën Vendore Arsimore Shkodër (ZVAP), për bashkëpunimin dhe kontributin teknik gjatë mbledhjes së të dhënave, verifikimit të situatës në terren dhe harmonizimit të prioriteteve vendore me politikat arsimore kombëtare.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive dhe sektorëve vendorë të arsimit, financave, infrastrukturës, shërbimeve sociale, si dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, edukatorëve dhe mësuesve që ofruan informacion të vlefshëm dhe reflektim mbi nevojat reale në terren.

Mirënjohje shkon edhe për organizatat e shoqërisë civile, këshillat e prindërve, grupet komunitare dhe partnerët lokalë, të cilët morën pjesë në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e realitetit arsimor dhe prioriteteve të komunitetit.

Ky plan përfaqëson një vullnet të përbashkët për të ndërtuar një sistem arsimor më të mirë, më gjithëpërfshirës dhe më të qëndrueshëm për çdo fëmijë në territorin e Bashkisë Shkodër

1.Hyrja

Qëllimi i këtij plani është hartimi i një platforme strategjike dhe gjithëpërfshirëse që do të hedhë bazat për një zhvillim të qëndrueshëm dhe cilësor për të gjitha strukturat e Arsimit parashkollor. Arsimi, konsiderohet si një nga sektorët me impakt të drejtpërdrejtë në mirëqënien sociale dhe ekonomike të Bashkisë Shkodër. Plani i përmirësimit synon të përmbushë nevojën për të harmonizuar të gjitha aktivitetet zbatuese në një vizion të përbashkët dhe koherent të fokusuar në disa objektiva strategjik.

Gjatë analizimit të të dhënave, vihet re qartë që një nga problematikat më kryesore të Bashkisë Shkodër është fakti që shumica e kopshteve ndodhen brenda godinave të shkollës. Nga ana infrastrukturore kopshtet brenda ndërtesave të shkollës kanë nevojë për një vlerësim teknik, për të vlerësuar se në cilat kopshte duhet ndërhyrë më parë, për ndërtimin e tualeteve për fëmijët me AK si dhe daljet emergjente.

Bashkia Shkodër gjatë viteve të fundit ka investuar në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të godinave të arsimit parashkollor në zonën urbane, ndërkohë që është duke parë me prioritet edhe godinat pranë Njësive Administrative që ndodhen në ambjentet e shkollave.

Bashkia po zbaton regjistrimin e fëmijëve sipas vendbanimit, në mënyrë që mos të kemi disa kopshte mbikapacitet dhe disa të tjerë nënkapacitet. Kjo ndihmon më mirë bashkinë për të planifikuar numrin e mësuesve dhe fëmijëve që do të ketë çdo kopsht. Bashkia duhet të vazhdojë zbatimin e procedurës standarte për regjistrimin.

Përsa i përket Ushqimit, Bashkia parashikon mundësinë e ofrimit të ushqimit në kopshtet në të cilat ka regjistrime dhe ka kërkesë nga komuniteti që të jenë kopshte me drekë, pasi nga të dhënat shihet qartë, që kopshtet me drekë kanë numër më të lartë regjistrimesh. Bashkia do të vlerësojë mundësinë e zgjerimit të ofrimit të ushqimit, aty ku është e mundur dhe të vlerësojë kthimin e një kopshti pa dreke, me kopësht me drekë aty ku kërkesa është më e madhe.

Qëllimi

Plani do të ketë një rol shumë të rëndësishëm për Bashkinë Shkodër dhe ai synon të përmirësojë në mënyrë të ndjeshme të gjitha proceset që lidhen me arsimin parashkollor. Konkretisht nëpërmjet planit synohet:

- Përmirësimi i shërbimit në kopshte ku regjistrimet janë të në mënyrë që të rriten regjistrimet;
- Planifikimi strategjik përsa i përket riorganizimit të infrastrukturës së kopshteve, me qëllim përsimirësimin e shërbimit në kopshtet që janë brenda shkollave, si dhe kopshteve që kanë nevojë imediate për restaurim;
- Bashkëpunimi i ngushtë me prindërit dhe komunitetin, për të ndërgjegjësuar për rëndësinë që ka

kopshti në zhvillimin e fëmijës;

Në pjesën e parë të dokumentit, gjendet një analizë përmbledhëse e cila do të përmbajë Vizionin, Misionin, Objektivat Strategjike të Planit, monitorimin dhe zhvillimin e tij.

Në pjesën e dytë dokumenti fokusohet në vendosjen e Objektiveve të përgjithshme dhe specifike për secilin proces dhe veprimin të planit të përmirësimit të shërbimit. Për të lehtësuar procesin e implementimit të planit, janë vendosur edhe indikatorët e performancës si dhe objektivat specifike për secilin kriter të përgjithshëm, që të fokusohemi mbi aktivitetet që duhen ndërmarre për të arritur objektivat e vendosur. Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjike.

Ndërkohë në pjesën e tretë është përmbledhur buxheti i nevojshëm për të realizuar ndërhyrjet në terren me qëllim rritjen e cilësisë në Arsimin Parashkollor, ku përfshin Planifikim afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit Parashkollor, Përmbledhja e Investimeve dhe Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve).

Shtrirja

Plani synon të përmirësojë shërbimin e Arsimit Parashkollor në Bashkinë Shkodër. Plani do të implementohet në të gjitha kopshtet që ka nën juridikson Bashkia Shkodër. Për mbarëvajtjen e aktiviteteve në plan dhe monitorimin e tij do të kujdeset Sektori i Arsimit, pranë Drejtorisë së Arsimit.

Vizioni

Përmirësimi i shërbimit të Arsimit Parashkollor, nëpërmjet ngritjes së strukturave për arsimin parashkollor, dhe fuqizimin e tyre për t'ju përgjigjur nevojave të fëmijëve.

Misioni

Shtimi i ambienteve arsimore për arsimin parashkollor dhe përmirësimi i cilësisë së tyre për të ofruar shërbim cilësor për çdo fëmijë të arsimit Parashkollor.

Objektivat

- Fuqizimi i Sektorit të Arsimit pranë Bashkisë Shkodër;
- Përmirësimi i ofrit të shërbimit në kopshte nëpërmjet organizimit të regjistrimeve sipas vendbanimeve;
- Përmirësimi i infrastrukturës të kopshteve;

- Ulja e numrit të grupeve të përziera në kopshte nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës;
- Ngritja dhe fuqizimi i strukturave mbështetëse të kopshtit (Bordi dhe Këshilli i prindërve, Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit);
- Përmirësimi i procesit të identifikimit dhe shërbimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, me aftësi të kufizuara dhe në nevojë për përfshirje sociale.

2. Procesi i Menaxhimit - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

Qëllimi

Proceset e menaxhimit nuk janë pjesë e ekzekutimit të menjëhershëm të detyrave, por vendosin objektiva strategjike dhe kushte kuadër që ndikojnë në llojet e tjera të procesit. Këto përfshijnë planifikimin, menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë.

Planifikimi i të gjithë sistemit parashkollor mbështetet në numrin e parashikuar të fëmijëve në moshën e kopshtit 0-6 vjeç, normën e pritshme të regjistrimit, si dhe shkallën e pritshme të frekuentimit. Kjo përbën planifikimin e kërkesës së arsimit parashkollor, duke marrë parasysh që arsimit parashkollor nuk është i detyrueshëm në Shqipëri.

Procesi i parashikimit ka gjithashtu edhe dimensionin e ofertës, që përfshin vlerësimin e numrit të mësuesve të nevojshëm, drejtorëve, mësuesve mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara, stafit mbështetës, si dhe objekteve (mjediseve), stafit shtesë etj.

Plani i përmirësimit të shërbimit në Proceset e Menaxhimit ka si qëllim përmirësimin e shërbimit të kopshtit duke siguruar ulje të numrit të fëmijëve në kopshtet e mbipopulluara; rritje të regjistrimeve në kopshtet nën kapacitet; ulje të numrit të grupeve të përziera dhe fëmijëve në to, dhe themelimin dhe fuqizimin e organizmave brenda institucionit të kopshtit.

Objektiva të përgjithshëm

Objektivat kryesorë të këtij plani në lidhje me Proceset e Menaxhimit janë:

1. Regjistrimi i fëmijëve sipas zonës së tyre të banimit dhe rritja e regjistrimeve përmes ndërgjegjësimit të prindërve dhe komunitetit për rëndësinë e arsimit parashkollor në formimin e fëmijës;
2. Krijimi i konceptit të kopshtit si komunitet duke organizuar aktivitete në çdo kopsht ku komuniteti mund të marrë pjesë dhe rritja e angazhimit të komunitetit në përmirësimin e shërbimit të arsimit parashkollor;
3. Themelimi dhe fuqizimi i organizmave si: Këshilli i Prindërve, Bordi i Kopshtit dhe Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, në mënyrë që të rritet ndikimi i tyre në proceset e

menaxhimit të kopshteve.

Regjistrimi i fëmijëve në kopshte

Në Drejtorinë e Arsimit në Bashkinë Shkodër janë 51 kopshte gjithsej, 21 kopshte janë në qytetin e Shkodrës (prej të cilave 7 kopshte ofrojnë ushqim) dhe 30 në njësitë administrative përreth.

Në Qytetin e Shkodër dhe në Njësinë Administrative Rrethina ndodhet numri më i madh i kopshteve publike. Ndërsa numri më i ulët i kopshteve publike ndodhen në:

Njësitë Administrative

- **Dajç**
- **Velipojë**
- **Ana e Malit**

Nuk ka kopshte të hapura në Njësitë Administrative

- **Pult**
 - **Shalë**
 - **Shosh**
- Shpërndarja e kopshteve publike sipas zonës gjeografike argumentohet me numrin e popullsisë të përqëndruar në çdo Njësi Administrative dhe nevojën e fëmijëve të grupmoshës 3- 6 vjeç për të përfituar nga shërbimi i kopshtit.

Në Bashkinë Shkodër frekuentojnë 1712 fëmijë në kopshte dhe 260 fëmijë në çerdhe. Norma e ulët e regjistrimit argumentohet me faktin se një pjesë e familjeve kanë emigruar nuk e kanë ndryshuar vendbanimin në Gjendjen Civile.

Një faktor tjetër i rëndësishëm që ndikon ndjeshëm në numrin e regjistrimit është përmirësimi i infrastrukturës së kopshtit si dhe ofrimi i ushqimit në kopshte dhe çerdhe. Sipas bashkisë kopshtet me ushqim, në godinë më vetë ose që janë rikonstruktuar së fundmi kanë numër më të lartë fëmijësh të regjistruar. Me kalimin e një kopshti nga pa drekë në kopsht me drekë, është vënë re që është rritur edhe numri i fëmijëve të regjistruar. E njëjta situatë vihet re edhe për kopshtet e rikonstruara.

Ndërkohë, ndarja e fëmijëve në grupe sipas grup moshës është prioritet sidomos për disa Njësi Administrative dhe për disa kopshte të zonës urbane, ku ndarja nuk mund të realizohet nga numri i vogël i fëmijëve në tërësi.

Bashkia Shkoder prej disa vitesh ndjek praktikën e regjistrimit të fëmijëve në kopësht sipas vendbanimit. Është hartuar procedura standarte e veprimit për regjistrimin në kopshte ku janë të përcaktuar qartë vendbanimet që i përkojnë kopshteve. Lista e fëmijëve që vjen nga çerdhet i përcillet kopshteve me shkresë zyrtare nga bashkia për t'u regjistruar dhe frekuentuar sipas vendbanimit.

Arsimi parashkollor synon zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor.

Arsimi parashkollor ndiqet nga fëmijët e moshës nga 3 deri në 6 vjeç.

DRAP-të dhe ZVAP-të, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore (kopshtet), do të ndjekin me përparësi detyrat si vijon:

- a) Marrjen e masave për rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve 3-6 vjeç në arsimin parashkollor.
- b) Regjistrimin me përparësi në institucionet arsimore parashkollore të fëmijëve me nevoja të veçanta: nga familjet në nevojë, nga pakicat kombëtare (romë, egjiptianë etj.) dhe fëmijë me aftësi të kufizuara.

Qëllimi kryesor është të arrihet një arsim parashkollor cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë që krijon kushte që të gjithë nxënësit, pa asnjë dallim, të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike, të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë.

Me rëndësi të veçantë është sigurimi i pjesëmarrjes së plotë në klasën përgatitore dhe arsimin e detyruar, si dhe ***rritja e aksesit në arsimin parashkollor.***

Me “klasë përgatitore” nënkuptohen klasat për fëmijë të moshës 5–6 vjeç që nuk kanë ndjekur arsimin parashkollor, të atashuara pranë shkollave të arsimit bazë, por edhe grupet e 3-ta në arsimin parashkollor, ku punohet me program të njëjtë. Po ashtu, synohet të rritet aksesit në arsimin parashkollor, për fëmijët e moshës 3–5 vjeç.

Stafi edukativ dhe mbështetës për shërbimet në Kopshte

Bashkia Shkodër mbulon me paga për njësinë e arsimit prej 232 punonjësish në total. Nga ky total 147 janë punonjës të Arsimit parashkollor, të përbërë prej 107 edukatore, 13 drejtues kopshti, 14 edukatore mbështetës, 8 kuzhinere dhe 5 nd/kuzhinere në Kopshte.

Bashkia Shkodër administron 51 kopshte nga të cilat, 21 kopshte janë në qytetin e Shkodrës (7 kopshte janë me drekë) dhe 30 kopshte në njësitë administrative përreth. Numri total i fëmijëve që i frekuentojnë kopshtet është 1712 fëmijë.

Drejtimi dhe menaxhimi i kopshtit.

- Drejtori i kopshtit menaxhon në mënyrë efektive burimet njerëzore.

- Drejtori i kopshtit ka kryer regjistrimin e fëmijëve sipas udhëzimeve zyrtare.
- Drejtori i kopshtit ka formuar grupet sipas grupmoshave, në përputhje me udhëzimet zyrtare.

Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta mes komunitetit dhe kopshteve.

DRAP-të dhe ZVAP-të, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore (kopshtet), do të ndjekin me përparësi detyrat si vijon:

- Trajtimin me përparësi nga këshillat e mësuesve dhe nga rrjetet profesionale të temave të mëposhtme:

Ndërgjegjësimi i prindërve për rëndësinë e frekuentimit të kopshtit nga fëmijët e moshës 3-6 vjeç.

Partneriteti kopsht – familje – komunitet.

- Kopshti ofron një mjedis të aksesueshëm dhe mikpritës për familjet dhe komunitetin.
- Kopshti fton shpesh prindërit të vëzhgojnë veprimtari të ndryshme të organizuara në kopsht.
- Kopshti vlerëson diversitetin e familjeve dhe të komunitetit si një vlerë të shtuar.
- Kopshti bashkëpunon me të gjitha familjet, pavarësisht prejardhjes së tyre kulturore, etnike, gjuhësore dhe shoqërore.

Analiza e shërbimit të arsimit parashkollor në vitin shkollor 2024 – 2025

Mbulimi i ofrimit të shërbimit të arsimit parashkollor

Në Bashkinë Shkodër shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Shkodër funksionojnë 7 çerdhe dhe 51 kopshte të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.

Njesia Administrative	Numri i Kopshteve
Shkodër	21
Rrethinat	9
Bërdicë	3
Guri i Zi	5
Postribë	5
Ana e Malit	4
Dajç	1
Velipojë	3

Frekuentimi në kopshte dhe gjithëpërfshirja

Në Bashkinë Shkodër 1712 fëmijë janë aktualisht të regjistruar në institucionet parashkollore publike. Për nxitjen dhe përfshirjen e komunitetit rom dhe egjiptian në politikat e arsimit të Bashkisë Shkodër është e rëndësishme që të mbahen në vëmendje këto indikator:

- Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të regjistruar në arsimin parashkollor, si dhe sigurimi dhe përmirësimi i kushteve për arsim cilësor gjatë fëmijërisë së hershme, nëpërmjet regjistrimit të të gjithë nxënësve romë dhe egjiptianë 3-6 vjeç në arsimin parashkollor.
- Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të përjashtuar nga tarifat për ndjekjen e arsimit parashkollor.
- Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që përfitojnë transport falas për në shkollë dhe kopësht.
- Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që përfshihen në aktivitete të QKF. Veprimtari të DAPSH për të eliminuar stereotipet që lidhen me romët dhe egjiptianët dhe numri i aktiviteteve të rishikuar do të paraqitet si indikator promovimi.

Infrastruktura dhe aksesueshmëria

Në Bashkinë Shkodër, infrastruktura e kopshteve paraqet një situatë të fragmentuar dhe të papërputhshme me standardet kombëtare. Vetëm 17 nga 51 kopshte ndodhen në godina të veçuara, ndërsa pjesa tjetër janë të integruara në ambientet e shkollave, shpesh pa përshtatje të duhura për moshën parashkollore. Kjo sjell kufizime në aksesin fizik dhe cilësinë e mjedisit edukativ. Mungesa e rampave për fëmijët me aftësi të kufizuara është e përhapur (23 kopshte), po ashtu edhe mungesa e tualeteve të përshtatura (40 raste). Në 8 kopshte, tualetet ndodhen ende jashtë godinës, duke u shoqëruar me kushte të papërshtatshme higjieno-sanitare. Për më tepër, një pjesë e kopshteve janë të papajisura me kënde lojrash funksionale. Për përmirësimin e situatës, nevojitet një program i mirëstrukturuar rikonstruksioni. Pajisja e kopshteve me rampa, tualete të përshtatura dhe kënde lojrash duhet të jetë pjesë e një investimi të planifikuar në mënyrë të balancuar, duke marrë parasysh edhe zgjerimin e shërbimit me drekë aty ku ka kërkesë të lartë.

Kopshtet “Edith Durahm”, “Ngjyrat”, “Xixëllonjat” “Njomëzat” janë identifikuar si pjesë e përpjekjeve të Bashkisë Shkodër për të sjellë arsimin parashkollor më afër komunitetit, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të integruar me shërbimet sociale e mbështetëse.

Shumica e kopshteve kanë vetëm 1 grup të përzier (kombinuar nga të gjitha moshat, shënuar si “123”), çka tregon për frekuentim të ulët dhe mungesë të stafit ose hapësirës për ndarje sipas moshës.

Vetëm disa kopshte të mëdha si “Ngjyrat”, “Ismet Sali Bruçaj”, “Ton Alimhilli” kanë 3 grupe të ndara (të para, të dyta dhe të treta), që është tregues i kapacitetit të lartë dhe funksionimit sipas standardit të ndarjes së moshave.

- Kopshte me 1 grup gjithsej: Rreth 30 kopshte kanë vetëm një grup edukimi (i përzier ose i thjeshtë).
- Kopshte me 2 grupe: Rreth 12 kopshte.
- Kopshte me 3 ose më shumë grupe: Vetëm 9 kopshte kanë 3 ose më shumë grupe, dhe ato janë kryesisht në zonat urbane.

Grupet e përziera janë më të zakonshmet, duke u përdorur në mbi 80% të kopshteve.

Grupet e veçanta përgatitore shfaqen në rreth 12 kopshte, që tregon nevojën për më shumë fokus në përgatitjen për shkollë.

Grupet e para, të dyta dhe të treta janë më të pranishme në kopshte me numër të lartë fëmijësh, kryesisht në qytet.

Tabela më poshtë paraqet shpërndarjen e grupeve edukative në kopshtet e Bashkisë Shkodër,

Kopshti	GR.I	GR.II	GR.III	Grupe të përziera	Gjithsej

“1 Qershori”	1		1	1	3
“Ngjyrat”	1	1	1	1	4
“Ajasëm”				1	1
“Ali Laçej”		1	1		2
“Azem Hajdari”		1	1		2
“Bep Tusha”	1	1	1		3
“Dëshmorët e Prishtinës”				1	1
“Fetah Barbullushi”	1	1	1		3
“Gjuhët e Huaja”				1	1
“Ismail Qemali”			1		1
“Ismet Sali Bruçaj”	1	1	1	1	4
“Liria”				1	1
“Njomëzat”	1	1	1		3
“Ndoc Mazi”			1	1	2
“Pashko Vasa”				1	1
“Edith Durham”	1	1	1		3
“Ruzhdi Daca”				1	1
Shirokë				1	1
“Ton Alimhilli”	2	1	1		4
“Zija Buliqi”			1	1	2
Zogaj				1	1
Bardhaj		1	1		2
Isa Jakupi			1	1	2
Haxhi Hajdari			1	1	2
Tring Smajli			1	1	2
Guci e Re				1	1
Hot i Ri				1	1
Shtoj i Ri				1	1
Shtoj i Vjetër				1	1
Zues				1	1
Elbacë				1	1
Muriqan			1	1	2
Oblikë				1	1
Hasan Dardhanjori		1		1	2
“Frederik Gjon Gjoni”				1	1
“Agim Tafili”				1	1
Trush	1	1	1		3
“Adem Haxhija”		1	1		2

Dragoç				1	1
Kullaj				1	1
Drisht				1	1
Mes-Myselim				1	1
“At Gjon Karma”			1	1	2
Kuç				1	1
Rrenc				1	1
Vukatanë				1	1
Shirq				1	1
Nikollë Zogorjani”				1	1
Nj.A.Velipojë				1	1
“Gjergj Vate Martini”				1	1
Juban				1	1

Planifikimi dhe regjistrimi

Ka një shpërndarje jo të balancuar midis kopshteve të mbingarkuara dhe atyre që punojnë nën kapacitet. Përballë këtyre sfidave, rekomandohet rishikimi i rrjetit ekzistues të kopshteve për të arritur një shpërndarje më të ekuilibruar të fëmijëve. Regjistrimi sipas vendbanimit është konsoliduar tashmë përmes Vendim me nr 568 datë 26.07.2024 "Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të kopshteve dhe çedheve të Bashkisa Shkodër".

Përfshirja sociale dhe mbrojtja e fëmijëve

Përfshirja e fëmijëve nga kategori të marginalizuara vijon të jetë sfiduese. Aktualisht, në kopshte janë të regjistruar vetëm 11 fëmijë romë, 16 egjiptianë dhe 24 fëmijë me aftësi të kufizuara. Këto shifra janë shumë më të ulëta sesa përfaqësimi i tyre në popullatën përkatëse.

Bashkia Shkodër ka ndërmarrë një punë të qëndrueshme dhe përpjekje të vazhdueshme për të garantuar përfshirjen e fëmijëve nga kategoritë e marginalizuara në institucionet arsimore parashkollore, si dhe për të identifikuar nevojat e tyre specifike. Një ndër pikat e forta është ngritja dhe funksionimi i Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe i Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF) në territorin e Bashkisë, çka siguron një mekanizëm institucional të rëndësishëm për mbështetjen dhe mbrojtjen e fëmijëve në situata risku.

Politikat dhe masat që lidhen me përfshirjen sociale, barazinë dhe mosdiskriminimin për minoritetet zbatohen në mënyrë të integruar përmes Drejtorisë së Shërbimeve Sociale, Rinisë, Strehimit dhe Shëndetit Publik të Bashkisë Shkodër dhe strukturave në varësi të saj.

Në kuadër të kësaj qasjeje funksionon prej vitit 2018 Qendra Komunitare Multifunkionale “Për

Familjen” e dedikuar për komunitetin rom dhe egjiptian, e cila ofron shërbime të integruara sociale, mbështetje psiko-sociale, orientim dhe ndërmjetësim për akses në shërbime publike, si dhe aktivitete ndërgjegjësuëse dhe përfshirëse për fëmijë dhe familje. Qendra Multifunktionale bashkëpunon ngushtë prej vitit 2018 me Fondacionin “Shpresë për Botën”, Food Bank, si dhe me organizata të tjera, duke ofruar shërbime mbështetëse dhe integruëse për komunitetin rom dhe egjiptian.

Kjo qendër ofron shërbime të integruara për individë dhe familje në nevojë, me fokus në mbështetjen psiko-sociale, orientimin dhe referimin në shërbime, organizimin e aktiviteteve edukuese e ndërgjegjësuëse, si dhe fuqizimin e komunitetit.

Në veçanti, vëmendje e shtuar i kushtohet fëmijëve, për të cilët ofrohet ndërmjetësim për regjistrimin në kopsht dhe shkollë, transport falas për në shkollë/kopësht, vakt ushqimor cdo ditë në këtë qendër, mjete didaktike çdo fillim vit si edhe shërbime tjera mbështetëse për familjen. Gjithashtu pranë kësaj qendre organizohen çdo ditë klasa pas-shkollore dhe përgatitore për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe shkollat, si dhe aktivitete edukative që synojnë përmirësimin e rezultateve arsimore dhe integrimin e tyre në shkollë/kopësht.

Klasat e prindërimit dhe fokus grupet kanë qëllim rritjen e kapaciteteve prindërore.

Aktivitete ndërgjegjësuëse kanë një rol thelbësor në fuqizimin e komuniteteve dhe në rritjen e aksesit të tyre në shërbime publike. Nëpërmjet informimit të drejtpërdrejtë, takimeve në terren, fushatave sensibilizuese dhe bashkëpunimit me aktorë lokalë, rritet niveli i njohjes mbi të drejtat, detyrimet dhe mundësitë që ofrohen në fusha si arsimi, mbrojtja sociale, regjistrimi civil, shëndetësia dhe programet e strehimit.

Këto aktivitete ndikojnë në reduktimin e barrierave informuese, në parandalimin e përjashtimit social dhe në rritjen e besimit ndaj institucioneve vendore, duke kontribuar drejtpërdrejt në përfshirjen sociale dhe ekonomike të komuniteteve. Struktura aktuale e punonjësve në këtë qendër përbëhet nga: 1 punonjës i Bashkisë Shkodër dhe 2 punonjës të organizatave partnere. Në total, 3 persona janë të angazhuar drejtpërdrejt në ofrimin e shërbimeve të dedikuara për komunitetin rom dhe egjiptian, në kuadër të një modeli bashkëpunimi institucional me shoqërinë civile.

Qeverisja dhe strukturat institucionale

Pjesa më e madhe e kopshteve kanë ngritur Këshillat e Prindërve, por këto struktura funksionojnë më shumë në mënyrë formale. Ka një rregullore të qartë mbi realizimin e mekanizmave të komunikimit institucional ndërmjet bashkisë dhe këtyre strukturave. Funksionimi aktiv i këtyre organizmave do të rrisë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e komunitetit në menaxhimin e shërbimit.

Shërbimi i arsimit sipas njësive administrative

Njësia Administrative: Shkodër

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të

hapura gjithsej 21 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

Kopshti	Emri Qytetit/Fshatit	Fshat/ Qytet	Me ushqim / Pa ushqim	Kapaciteti	Ne ndertesen e shkolles
“1 Qershori”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	30	Po
“Ngjyrat”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	120	Jo
“Ajasëm”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	20	Po
“Ali Laçej”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	50	Po
“Azem Hajdari”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	50	Po
“Bep Tusha”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	115	Jo
“Dëshmorët e Prishtinës	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	20	Po
“Fetah Barbullushi	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	80	Jo
“Gjuhët e Huaja”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	30	Po
“Ismail Qemali”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	25	Po
“Ismet Sali Bruçaj”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	120	Jo
“Liria”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	30	Po
“Njomëzat”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	100	Jo
“Ndoc Mazi”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	50	Po
“Pashko Vasa”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	50	Po
“Edith Durham”	Shkodër	Qytet	Me ushqim	80	Po
“Ruzhdi Daca”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	25	Jo
Shirokë	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	25	Po
“Ton Alimhilli”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	120	Jo
“Xixëllonjat”	Shkodër	Qytet	Pa ushqim	120	Jo
Zogaj	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	20	Po

Njësia Administrative: Ana e Malit

Kopshtet

Aktualisht, në territorin e njësisë Ana e Malit janë të hapura gjithsej 4 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit

“Qazim Mehja”

“Hasan Dardhanjori”

“Veli Tela”

Elbacë

Njësia Administrative: Bërdicë

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative janë të hapura gjithsej 3 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit

“Frederik Gjon Gjoni”

“Agim Tafili”

“Seit Can Tagani”

Njësia Administrative: Dajç

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon 1 kopesht.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit

Shirq - “Pjetër Gaci”

Njësia Administrative: Guri i Zi

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative aktualisht, janë të hapura gjithsej 5 kopshte, të shpërndara në zona të

ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit

Guri i Zi - “At Gjon Karma”

Kuç

Rrenc

Vukatanë “Arif Selimi”

Juban - “Zef Jubani”

Njësia Administrative: Postrinë

Kopshtet

Në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 5 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit

Dragoç

Postrinë

Kullaj

Drisht - “Adem Haxhija”

Mes Myselim

Njësia Administrative: Rrethinat

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative funksionon një rrjet kopshtesh që synon të ofrojë edukim cilësor dhe mbështetje zhvillimore për fëmijët e moshës 3-6 vjeç. Aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 9 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit. Këto institucione luajnë një rol të rëndësishëm si në përgatitjen e hershme për shkollë, ashtu edhe në mbështetjen sociale të familjeve.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit

Dobraç- “Isa Jakupi”
Golem
Guci e Re
Shtoj i Ri
Shtoj i vjetër
Hot i Ri
Grudë e Re- “Tringë Smajli”
Zues
Bardhaj

Njësia Administrative: Velipojë

Kopshtet

Në kuadër të shërbimeve arsimore dhe kujdesit ndaj fëmijëve të moshës parashkollore, në këtë njësi administrative aktualisht, në territorin e njësisë janë të hapura gjithsej 3 kopshte, të shpërndara në zona të ndryshme për të siguruar akses të barabartë për familjet e komunitetit.

Lista e kopshteve përfshin:

Emri i kopshtit

Velipojë – Njësia Administrative
“Gjergj Vatë Martini”
“Nikoll Zagorjani”

Organizmat e Institucionit Arsimor

DRAP-të dhe ZVAP-të në bashkpunim me drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore (kopshtet), do të ndjekin me përparësi, ngritjen në çdo institucion arsimor parashkollor të Bordit të kopshtit, Këshillit të Prindërve, Këshillit të mësuesve dhe Komisionit të etikës e sjelljes, sipas legjislacionit në fuqi.

Këshilli i Prindërve

Nga analiza e Arsimit Parashkollor në Bashkinë Shkodër rezulton se 51 kopshtet e kanë themeluar Këshillin e Prindërve. Numri i anëtarëve të Këshillit të Prindërve, që i përkasin gjinisë “femër” në qytetin e Shkodrës, është më i lartë në raport me numrin e anëtarëve të gjinisë “mashkull”. Përsa i përket numrit të anëtarëve rezulton se numri minimal i anëtarëve të Këshillit të Prindërve është 3, numri mesatar është 5, ndërsa numri maksimal është 9.

Sipas neni 90/pika 1: Këshilli i Prindërve mbledhet të paktën tre herë në vit. Ndërkohë, numri minimal i mbledhjeve të Këshillit të Prindërve është 1, mesatarja e mbledhjeve është 3 dhe maksimumi i mbledhjeve është 9.

Temat që diskuton këshilli i prindërve, të cilat kanë nevojë të diskutohen në nivele më të larta, për të gjetur zgjidhje:

- Problematikat e kopshtit.
- Mjetet didaktike.
- Integrimi i fëmijëve që kanë nevojë për përfshirje sociale dhe fëmijëve me probleme në të nxënë.
- Marrëdhëniet kopësht-komunitet- drejtori arsimore.

Bordi i Kopshtit

Referuar Udhëzimit Nr. 25, bordi përbëhet nga 7 anëtarë, ndërkohë në kopshtet publike të Qytetit Shkodër, numri minimal i anëtarëve të bordit të kopshtit është 3, numri mesatar është 5, ndërsa numri maksimal i anëtarëve është 8.

Sipas Udhëzimit, Nr. 25, në ngritjen e bordit u kushtohet kujdes i veçantë përfaqësimit gjinor. Në kopshtet e qytetit të Shkodrës, pjesa më e madhe e anëtarëve, i përkasin gjinisë “femër”, konkretisht numri mesatar i anëtarëve të gjinisë “femër” është 3, ndërsa numri mesatar i anëtarëve “meshkuj” është 1.

Bordi mbledhet jo më pak se tri herë në vit. Mbledhjet e tjera zhvillohen me nismën e kryetarit të bordit ose të shumicës së thjeshtë të anëtarëve të tij. Ndërkohë, në Bashkinë e Shkodër, numri minimal i mbledhjeve të bordit në kopshtet publike të qytetit është 2, numri mesatar është 3, ndërsa numri maksimal është 9.

Disa nga veprimtaritë që kryhen dhe tematikat që duhet të diskutohen në bord janë:

- Merr pjesë në procedurat e emërimit e të largimit të anëtarëve të bordit.
- Shqyrton rregulloren e brendshme të institucionit.
- Ndjekë përmbushjen e objektivave të planit vjetor të institucionit.
- Kontributi vullnetar i prindërve.

- Nevojat imediate të fëmijëve.
- Siguria e fëmijëve.
- Infrastruktura përmirësimi dhe mirëmbajtja e kushteve fizike të ambjenteve..

Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit

Pjesa më e madhe e kopshteve publike, kanë themeluar Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, sipas Urdhërit nr.31 datë 28.01.2020 “Për Miratimin e Rregullores për funksionimin e institucioneve Arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni i shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit ka në përbërje të tij edhe prindër të caktuar nga këshilli i prindërve. Referuar të dhënave të mbledhura, në të gjitha kopshtet që e kanë themeluar Komisionin e Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit, rezulton se pjesë e këtij të fundit janë dhe anëtarë nga Këshilli i Prindërve,

3.Proceset Kryesore - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

Qëllimi

Proceset kryesore janë ato procese që i shërbejnë drejtpërdrejt përbushjes së objektivave strategjike ose qëllimit të institucionit. Këto procese ofrojnë një pjesë të konsiderueshme të performancës së një institucioni dhe konsumojnë një pjesë të konsiderueshme të burimeve. Në lidhje me kopshtet publike, fëmijët regjistrohen dhe mbërrijnë në objekt (këtu fillon procesi) dhe largohen pasi të kenë marrë arsimin parashkollor (procesi përfundon).

Plani i përmirësimit të shërbimit ka si qëllim rritjen e identifikimit, vlerësimit dhe trajtimit më të mirë të rasteve të fëmijëve, pjesë e kategorive që përbëjnë rrezik për përjashtim social (fëmijët rom dhe egjiptian, fëmijët e përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike, fëmijët jetimë, me prindër të divorcuar, fëmijë viktimë të dhunës dhe abuzimit, etj), fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe fëmijët me aftësi të kufizuar.

Objektiva të përgjithshëm

Objektivat kryesore të planit të përmirësimit në lidhje me Proceset Kryesore janë:

1. Rritja e identifikimit dhe vlerësimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për përfshirje sociale, në nevojë për mbrojtje dhe me aftësi të kufizuar;
2. Përmirësimi i procesit të menaxhimit të rasteve të identifikuara të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në nevojë për përfshirje sociale dhe me aftësi të kufizuar;
3. Ngritja e një sistemi të unifikuar në nivel vendor për Bashkinë Shkodër për mbledhjen e të dhënave, përpunimin dhe analizimin e tyre për të gjithë fëmijët në nevojë për përfshirje sociale;
4. Hartimi i politikave dhe ofrimit të paketës së shërbimeve për fëmijët në nevojë për përfshirje sociale dhe në moshë për kopësht për lehtësimin e aksesit të tyre në kopësht;
5. Ofrimi i asistencës për fëmijët e identifikuar brenda ambientit të kopshtit. Ofrimi i shërbimit i paketës së shërbimeve psiko-sociale dhe shërbime të tjera në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese për të shmangur përjashtimin social.

Përfshirja sociale

Koncepti i përfshirjes sociale

Koncepti i përfshirjes sociale zbulon natyrën e ndërthurur dhe shumë-dimensionale të mungesës kronike që rrjedh nga përjashtimi social, si për shembull nga diskriminimi, që shërben si shtysë e rëndësishme e aspekteve më të thjeshta dhe lehtësisht të vëzhgueshme të varfërisë (mungesa e shkollimit, shëndeti i dobët, dhe niveli i ulët i pjesëmarrjes apo kthimit në tregun e punës).

Qasja në shërbime është thelbësore për përmirësimin e kushteve në bazë të cilave individët marrin pjesë në shoqëri, dhe mundësia për të kërkuar hapësirë për pjesëmarrje është thelbësore për përfshirjen. Në këtë dokument ky koncept i referohet rasteve të fëmijëve në moshë për kopësht duke përfshirë kategoritë e fëmijëve të përfshirë në skemën e ndihmës ekonomike si dhe fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian.

Mbrojtja e fëmijëve

Identifikimi i abuzimit dhe neglizhimit të fëmijës

Në Bashkinë Shkodër, Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF), është një strukturë e atashuar pranë Drejtorisë së Shërbimit Social, i cili përmban PMF për bashkinë qendër. Në Njësitë e tjera Administrative (fshatrat) që ka PMF në Postribë, Shalë, Shosh, Pult, në Rrethina, në Dajç, Velipojë, Bërdicë, dhe në Gur të Zi, Ana e Malit. Në Njësitë e tjera Administrative (fshatrat) që nuk ka PMF realizohet nga administratori i njësisë.

Rritja e bashkëpunimit me strukturat arsimore do të ketë si qëllim shkëmbimin reciprok të informacionit për fëmijët e moshës parashkollore, për të realizuar vlerësimin e drejtë të aftësive për kryerjen e veprimtarive bazë të jetës, në përputhje me grup-moshat, si edhe për të siguruar identifikimin dhe plotësimin e nevojave aftësuese të këtyre fëmijëve në kuadrin e sistemit arsimor gjithëpërfshirës e special.

Nuk ka patur raste të identifikimit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje në kopshtet e Bashkisë

Shkodër. Çdo rast i identifikuar në nevojë për mbrojtje raportohet pranë NJMF.

Bashkia Shkodër duhet të plotësojë nevojat në lidhje me shërbimin psiko – social në arsimin parashkollor sipas Urdhrit nr. 483 date 19.09.2025 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 313 date 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit psikosocial në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial”, i ndryshuar.

Urdhërit Nr.21 date 22.08.2025 Për një shtesë në Udhëzimin nr 26 date 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”

Në këtë mënyrë bashkia synon që në vitet e ardhshme të:

- Rritet e numri i fëmijëve në moshë kopshti që përfitojnë shërbimin psiko-social;
- Rritet numri i fëmijëve të identifikuar në nevojë për mbrojtje të raportuar pranë PMF;
- Rritet numri i fëmijëve që marrin shërbime të specializuara sipas nevojave;
- Krijohet dosje individuale për çdo fëmijë që përfiton nga shërbimi psiko-social, ku përfshihet praktika e vlerësimit dhe plani i ndërhyrjes.

Objektivat kryesore janë:

- 1.Parandalimi, identifikimi, raportimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.
- 2.Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve punojnë ngushtësisht me stafet e kopshteve për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe menaxhimin e rasteve nëpërmjet GTN (grupeve teknike ndërsektoriale) për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve por edhe trajtimin në vazhdimësi të tyre.
- 3.Organizimi i paketave trajnuese për stafet e punonjësve për t’u njohur me shërbimet mbrojtëse për fëmijët dhe kryesisht të rolit të tyre në të gjithë këtë proces.
- 4.Vendosja e PMF-ve në kontakt me stafin e kopshteve në lidhje me çështjet e mbrojtjes së fëmijëve. Çdo kopsht ka të hartuar, të miratuar dhe të njohur nga stafet, politikat e mbrojtjes së fëmijëve.

Fëmijët me aftësi të kufizuara

Adresimi i prindërve

DRAP-të dhe ZVAP-të, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore (kopshtet), do të ndjekin me përparësi detyrat si vijon:

- 1.Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesit ndihmës sipas legjislacionit në fuqi. 23

2.Hartimin dhe zbatimin e planeve edukative individuale për fëmijët me aftësi të kufizuara, nga mësuesit e arsimit parashkollor në bashkëpunim me personat që ushtrojnë përgjegjësinë prindërore të fëmijëve, psikologë, punonjës socialë.

Kopshti mbështet fëmijët me nevoja të veçanta. Ka për qëllim të nxisë përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë shqiptare, të parandalojë diskriminimin dhe të eliminojë pengesat për të pasur akses në shërbimet publike dhe realizimin e të drejtave të tyre.

Në kopshtet publike të Bashkisë Shkodër janë të regjistruar 24 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe ka 14 mësuese ndihmëse.

Bashkia Shkodër ka si objektiv krijimin e ambjenteve dhe mjediseve të sistemit arsimor parashkollor të sigurtë sipas standarteve ligjore.

Gjatë monitorimit të situatës së arsimit parashkollor (kopshte) është evidentuar se, mësuesit e kopshteve hasin probleme me prindërit, në momentin që ata dyshojnë se fëmija mund të jetë me aftësi të kufizuar, prandaj kjo gjë ndikon në vonimin e procesit të diagnostikimit të fëmijëve dhe trajtimin e tyre sa më parë. Ndërgjegjësimi i prindërve mbi këtë aspekt është një prioritet i Drejtorisë së Arsimit. Shërbimi psiko-social gjithashtu ofron mbështetje nëpërmjet psikologëve ose punonjësve socialë për trajtimin e problematikave të rasteve të ndryshme, vlerësimin e rasteve të fëmijëve me nevoja të veçanta psiko-sociale, hartimin e programeve parandaluese.

Objektivat kryesore janë:

1. Përmirësimi i procesit të diagnostikimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar ku duhet të ketë infrastrukturë të përshtatshme për to (ndërtimi i rampeve, klasat burimore për fëmijët AK etj).
2. Përmirësimi i komunikimit mësues-prind gjatë procesit të diagnostikimit të fëmijës nëpërmjet trajnimit të stafit të kopshteve.

4.Proceset Mbështetëse - Veprimet e Planit të Përmirësimit të Shërbimit

Qëllimi

Proceset mbështetëse janë procese që ofrojnë mbështetje dhe duhet të gjënden brenda ose jashtë institucionit.

Një proces mbështetës në kopësht, mund të jetë shtimi i burimeve njerëzore pranë Bashkisë, për të koordinuar aktivitetin e planit të përmirësimit të arsimit parashkollor.

Planet e përmirësimit të shërbimit kanë si qëllim ofrimin e shërbimit sa më efikas të kopshteve në aspektin e edukimit të fëmijëve, sigurisë, zhvillimit të tyre dhe sigurimin e aksesueshmërisë së shërbimit nga të gjithë. Plani fokusohet në përmirësimin e infrastrukturës së godinave të kopshteve, formimin dhe ngritjen e kapaciteteve në mbështetje të arsimit parashkollor si dhe gjithëpërfshirjen e fëmijëve në të gjitha strukturat e arsimit parashkollor të territorit që mbulon Bashkia Shkodër.

Objektiva të përgjithshëm

Objektivi kryesor i planeve të përmirësimit të shërbimit në lidhje me Proceset Mbështetëse është arritja e standardeve të vendosura nga aktet ligjore përse i përket numrit të stafit të kopshteve, rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes së godinave, llojet e materialeve didaktike, cilësinë e ushqimit dhe sigurimin e aksesit në kopësht.

Trajnimi i stafit

Drejtori i kopshtit ka ndarë detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të kopshtit, sipas nevojave të kopshtit dhe aftësive e përvojave profesionale të stafit.

Trajnimi i stafit duhet të trajtohet sipas në Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.56 date 25.09.2025 “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të perbashketa midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore. Akademia e trajtimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”. Ky vendim ka të bëjë me trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit të bashkisë për të përmirësuar shërbimet, përfshirë arsimin parashkollor.

Gjatë vitit 2025 vetë Bashkia Shkodër ka organizuar trajnime me mësueset e kopshteve në fushat: Bashkëpunim me prindërit për fëmijët me aftësi ndryshe, disiplinimi pozitiv i fëmijëve, teknikat për nxitjen e zhvillimit të gjuhës dhe komunikimit, integrimi social dhe gjithëpërfshirës, çrregullimet e spektrit autik dhe mbështetje specifike për fëmijët e parashkollorit.

Objektiva kryesore janë:

- Kryerja e trajnimeve vjetore akredituese të stafit të kopshteve nga ASCAP.
- Trajnimi i stafit të kopshteve për rastet e emergjencave, ndihmën e parë, përdorimin e internetit, microsoft office, etj.

Menaxhimi i godinave

Rikonstruksioni i kopshteve

Pjesa më e madhe e kopshteve publike në territorin e Bashkisë Shkoder ndodhen brenda godinave të shkollave. Nga 51 kopshte publike në total, 17 prej tyre janë në godinë më vete.

Gjatë analizës së situatës së arsimit parashkollor në Bashkinë Shkoder u evidentua se një pjesë e madhe e kopshteve kanë nevojë për rikonstruksion. Disa nga nderhyrjet më emergjente janë në sistemin elektrik në kopshte, mungesën e rampave si dhe rikonstruksioni i brendshëm e i jashtëm i godinave. Shumica dërrmuese e kopshteve nuk kanë tualete për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Gjatë periudhës së pushimit hartohet një plan pune të cilat kryejnë mirëmbajtjen e godinës për vitin pasardhës. Mirëmbajtja bëhet çdo vit në çdo kopsht. Ka kërkesa në rritje për kopshte me drekë.

Objektivat kryesorë janë:

- Rikonstruksioni i godinave duke iu përmbajtur standardeve për hapësirat e kopshteve dhe facilitetet e nevojshme.
- Rikonstruksioni i godinave të kopshteve në tërësi.

Materialet

Planifikimi i nevojës për materiale

Përsa i përket materialeve didaktike, Drejtueset e kopshteve janë pyetur nëse kopshtet disponojnë materiale didaktike për çdo fëmijë dhe shuimica prej tyre janë përgjigjur pozitivisht. Ka kopshte që duhet të përmiresohet disponueshmëria e materiale didaktike për çdo fëmijë.

Çdo vit Drejtorët e kopshteve në bazë të programit unifikojnë listën e materialeve që çdo fëmijë duhet të ketë në bazë të nevojave.

Kopshti në bashkëpunim me prindërit përzgjedh bazën materiale dhe didaktike sipas grupeve të fëmijëve.

Hartimi i një liste të unifikuar të materialeve didaktike për të siguruar zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve, bazuar në “Standartet e Zhvillimit dhe të të Nxënit të fëmijëve 3-6 vjeç” është në proces përmirësimi për të plotësuar nevojat e përgjithshme të planit vjetor didaktik.

Ushqimi

Planifikimi i shërbimit të ushqimit në kopshte

Kopshtet duhet të ofrojnë ushqim sipas urdhërit të MSHMS nr. 76/1, i datës 24.01.2018 dhe urdhërit nr. 457, i datës 13.06.2018, “Mbi menunë e ushqimit në qendra shëndetësore dhe kopshte”.

Institucionet parashkollore që ofrojnë ushqim në Bashkinë Shkodër janë 14 në total, 7 janë Kopshte dhe 7 Çerdhe, të cilat ndodhen të gjitha në Njësinë Administrative Shkodër.

Siç e kemi evidentuar më sipër, kopshtet me drekë numër të lartë fëmijësh dhe kanë kërkesa më të larta për rregjistrim.

Në disa zona kërkesa e prindërve për kopshtet me drekë është e lartë dhe planifikohet nga bashkia që numri i kopshteve me drekë të rritet.

Bashkia do të vlerësoje mundësinë e kthimit të një kopshti pa drekë në kopsht me drekë, duke u bazuar në kërkesat e prindërve dhe mundësinë infrastrukturore për të plotësuar standartet, në mënyrë që një kopsht pa ushqim të kthehet në kopsht me ushqim.

Shpërndarja e ushqimit kryhet çdo ditë nga personi përgjegjës i magazinës të bashkisë pranë kopshteve. Komisioni i marrjes në dorëzim është prezent për të vlerësuar produktet ushqimore të dërguara nga furnitori. Transporti kryhet nga shoferi me mjet frigoriferik. Ushqimi merret në dorëzim nga kuzhinierja e kopshtit. Nga AKU kryhen kontrole një herë në 3 muaj.

Përfundimi nga Tarifa e Shërbimit për ushqim kryhet nga institucionet e Kopshteve dhe Çerdheve të Bashkisë Shkodërnë bashkëpunim me Shërbimete Sociale. Për vitin 2025 {sipas VKB Nr. 25 Datë 20.12.2019 “Për disa ndryshime në VKB Nr.1 Datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifatat vendore”} kopshte kanë përfunduar 11 fëmijë ndërsa në çerdhe 10 fëmijë.

Buxheti

Planifikimi afatmesëm buxhetor i shërbimit të Arsimit parashkollor

Të ardhurat vendore dhe transferimet nga qeveria qendrore për shërbimin e arsimit parashkollor

Të dhënat financiare për shërbimin e arsimit parashkollor

Ky seksion përmbledh informacionin financiar që lidhet me funksionimin dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parashkollor në nivel bashkie.

Bashkia siguron financim për arsimin parashkollor bazuar në të ardhurat përmes transfertave specifike dhe të përgjithshme të siguruara nga qeveria qendrore si dhe nga taksat dhe tarifatat vendore.

Arsimi parashkollor përfshirë pagat e stafit arsimor dhe ndihmës, kostot e mirëmbajtjes dhe funksionimin e infrastrukturës së kopshteve, rikonstruksione kopshte/çerdhe, si dhe mbështetjen për përfshirje të fëmijëve nga grupe vulnerabël.

Të dhënat financiare janë të raportuara në mijë lekë dhe pasqyrojnë kontributin për secilën kategori për vitin aktual, si dhe për vitet e mëparshme për të mundësuar analizë krahasimore.

Ky informacion është i domosdoshëm për të kuptuar financimin buxhetor të shërbimit të arsimit parashkollor, mënyrën e plaifikuar të përdorimit të fondeve publike për arsimin parashkollor, si dhe për të identifikuar boshllëqet ose mundësitë për investime të reja në funksion të përmirësimit të cilësisë së edukimit.

Shpenzimet e Programit sipas kategorive ekonomike të Arsimit PBA 2026-2028

NJVQV Bashkia Shkodër
Programi AI 141 Arsimit

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	PLANI	PLANI	PLANI
		2026	2027	2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	510,194	510,195	510,195
600	Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli	440,182	440,183	440,183
601	Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore	70,012	70,012	70,012
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	206,445	208,422	208,422
602	Mallra dhe sherbime te tjera	190,445	192,422	192,422
604	Transferime korrente te brendeshme	16,000	16,000	16,000
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	81,304	16,705	37,696
230	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara	16,519	0	0
231	Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara	64,785	16,705	37,696
TOTALI		797,943	735,322	756,313

Projektet e Investimeve të Programit

KODI	EMËRTIMI PROJEKTIT/PRODUKTIT	BURIMI I FINANCIMIT	DATA	DATA	KOSTO TOTALE	2026	2027	2028
			FILLIMIT	PËRFUNDIMIT		PLANI	PLANI	PLANI
Shpenzimet Kapitale sipas Projekteve								
P912A CD	Rikonstruksion Kopshti Ton Alimhilli (P912ACD)	Financim Brendshëm	1/1/2025	12/31/2026	4,600	4,600	0	0
P043-SH- 004	Rikonstruksion Cerdhe Perash	Financim Brendshëm	1/1/2026	12/31/2026	1,640	1,640	0	0
Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Projekteve					6,240	6,240		
Shpenzimet Kapitale sipas Produkteve								
	Objekte të Arsimit Baze dhe Parashkollor të Mirëmbajtura dhe funktionale					19,200	5,700	5,700
V912AAD	Fëmijë që Ndjekin Kopështin					4,000	4,000	4,000
V043AAC	Fëmijë që Frekuentojnë Çerdhet					400	400	400
Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Produkteve						23,600	10,100	10,100
Totali i Përgjithshëm						29,840	10,100	10,100

Buxheti që mbështet planin për Zhvillimin dhe mbështetjen e arsimit parashkollor për periudhën 2026–2028. Programi AI 141 Arsimi PBA 2026-2028 Përmbledhje e investimeve (2026–2028)

Investimet në arsimin parashkollor (2026–2028)

Për arsimin parashkollor, plani i investimeve fokusohet kryesisht në **rikonstruksionin e kopshtit “Ton Alimhilli”** në qytetin e Shkodrës. Ky projekt përfshin përmirësime të plota infrastrukturore me qëllim garantimin e sigurisë, funksionalitetit dhe përputhjes me standardet bashkëkohore për mjediset e edukimit të hershëm.

Ky investim i vetëm, me vlerë **4.6 milionë lekë**, është planifikuar të realizohet i tëri gjatë vitit 2026. Ai përfaqëson një nga ndërhyrjet më të rëndësishme në sektorin parashkollor për periudhën trevjeçare dhe synon të përmirësojë drejtpërdrejt përfshirjen dhe përvojën e fëmijëve në edukimin parashkollor në zonat me dendësi më të lartë të popullsisë.

Për arsimin parashkollor, plani i investimeve fokusohet kryesisht në **rikonstruksionin e çerdhes “Perash”** në qytetin e Shkodrës. Ky investim i vetëm, me vlerë **1.6 milionë lekë**, është planifikuar të realizohet i tëri gjatë vitit 2026. Ai përfaqëson një nga ndërhyrjet më të rëndësishme në sektorin parashkollor për periudhën trevjeçare dhe synon të përmirësojë drejtpërdrejt përfshirjen dhe përvojën e fëmijëve në edukimin parashkollor.

Ndërkohë, është planifikuar një program i posaçëm për **mirëmbajtjen dhe funksionalitetin e Objekteve të Arsimit Baze dhe Parashkollor**, me një total investimi prej **19.2 milionë lekësh** përgjatë vitin 2026, **5.7 milion leke** për vitin 2027 dhe **5.7 milion** për vitin 2028. Ky program përfshin ndërhyrje të vazhdueshme për të siguruar vazhdimësinë e kushteve bazë në institucionet ekzistuese.

Gjithashtu është planifikuar një program i posaçëm për **Fëmijë që frekuentojnë Kopshtin** me shumën **4 milion lekë** për secilin vit 2026, 2027, 2028 dhe një program tjetër i posaçëm për **Fëmijë që frekuentojnë Çerdhet** me shumën **400 mije lekë** për secilin vit 2026, 2027, 2028.

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parashkollor kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

1	Qëllimi i Politikës së Programit	Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.			
	TP për Qëllimin:	2025		2029	
	Numri mesatar i fëmijëve për çdo punonjës mësimor arsimi baze (Rap. nr. nx/nr. mesuesve arsimi baze)	8.07		9.62	
	Nxënës në klasë: Numri mesatar i nx. në një klase arsimi baze (Rap. nr. i nx/nr. klasave)	14		15	
	Edukator për fëmijë kopshti ; Numri mesatar i fëmijëve për kopësht (Raport numrit të fëmijëve kund (Rap. nr fëmijë/nr. kop)	39		39	
1.1	Objektivi i Politikës së Programit	Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilesore per zhvillimin e procesit mesimor ne sistemin parauniversitar dhe parashkollor.			
	TP për Objektivin:	2025	2026	2027	2028
	Raporti numrit të nxenesve kundrejt numrit total të mesuesve në arsimin bazë (Nr. nx/Nr.mesuesve)	8.07	9.62	9.62	9.62
	Numri i shkollave në arsimin 9-vjecar; qytet/fshat (Nr. Shkollave)	67	70	70	70
	Numri mesatar i nxënësve në një klase arsimi baze (Rap. nr. nx/nr. klasave)	14	15	15	15
	Numri i shkollave që ngrohen me dru zjarri arsimi baze (Nr. shkollave)	64	49	49	49
	Numri i shkollave që ngrohen me kaldaja dhe naftë arsimi baze (Nr. shkollave)	5	9	9	9
	Numri i mjeteve të transportit në shërbim (Nr. automjeteve)	4	4	4	4
	Numri i shkollave që i shërbejnë fëmijëve me aftësi të veçanta (Nr. shkollave)	1	1	1	2
	Numri i shkollave me shërbim sigurie arsimi baze (Nr. Shkollave)	50	26	26	26
Numri mesatar i fëmijëve për kopësht (Raporti numrit të fëmijëve kundrejt numrit total të kops (Nr. femij./Nr. Kopshteve)	39	39	39	39	

	Numër kopshte (Nr. kopshte)	51	51	51	51
	Numri i kopshteve me dreke (Nr. kopshte me dreke)	7	7	7	7
	Numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtet me drekë (Nr. fëmijëve)	370	355	355	355
	Sipërfaqe në m2 në shërbim të kopshteve që mirëmbahet (Siperfaqja m2)	6972	6972	6972	6972
	Numri i fëmijëve në nevojë dhe me aftësi të kufizuar të mbështetur nga bashkia në kopshte (Nr. i fëmijëve)	45	45	45	45
1.2	Objektivi i Politikës së Programit	Krijimi i ambjenteve dhe mjediseve të sistemit arsimor bazë dhe parashkollor, të sigurtë konform standardeve ligjore.			
	TP për Objektivin:	2025	2026	2027	2028
	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të nxenesve të arsimit (Rap.shpenzime/ nr .nx)	44.57	44.84	40.14	40.89
	Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të (Rap.shpenzime/Nr i institucioneve)	4542	4926	4410	4492
	Numri mesatar i fëmijëve për kopësht (Nr i fëmijëve ne kopshte)	39	39	39	39
	Numër kopshte (Nr. kopshte)	51	51	51	51
	Numri i kopshteve me dreke (Nr. kopshte me dreke)	7	7	7	7
	Numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtet me drekë (Nr. fëmijëve)	370	355	355	355
	Sipërfaqe në m2 në shërbim të kopshteve që mirëmbahet (Siperfaqja m2)	6972	6972	6972	6972
	Numri i fëmijëve në nevojë dhe me aftësi të kufizuar të mbështetur nga bashkia në kopshte (Nr. i fëmijëve)	45	45	45	45
	Objektivi i Politikës së Programit	Krijimi i ambjenteve dhe mjediseve të sistemit arsimor bazë dhe parashkollor, të sigurtë konform standardeve ligjore.			
	TP për Objektivin:	2025	2026	2027	2028
		20	202	202	2
		0	6	7	0
		2			2

	5			8
Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të nxenesve të arsimit (Rap.shpenzime/nr .nx)	4 4 5 7		44. 84	40. 14
Raporti i shpenzimeve në institucionin e arsimit bazë kundrejt numrit total të institucioneve të (Rap.shpenzime/Nr i institucioneve)	4 5 4 2		492 6	441 0
Numri mesatar i fëmijëve për kopësht (Nr i fëmijëve në kopësht)	3 9		39	39

Qëllimi 1 (Q1) Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor

Objektivi specifik O1.1 Sigurimi i mjediseve dhe objekteve cilësore për zhvillimin e procesit mësimor në sistemin parauniversitar dhe parashkollor. (Sipas treguesit)

Aktivitetet	Periodha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Të dhëna dhe/ose Tregues
Angazhimi i mësuesve ndihmës në kopështet dhe stafit mbështetës për rritjen e efikasitetit edukativ.	2026–2028	Drejtoria Arsimit, Burimet Njerëzore,	OJQ Sociale, MAS	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike përfshirë në zërin “Paga Shperblime dhe te tjera shpenzime personeli” dhe “Kontribute për sigurime shoqerore dhe shendetesore”	— Numri i kopështeteve. — Numri i fëmijëve që frekuentojnë kopështet me drekë. — Nr. i fëmijëve në nevojë dhe me aftësi të kufizuar të mbështetur nga bashkia në kopështet. — Numri mesatar i fëmijëve për kopështet.
Institucionalizimi dhe funksionalizimi i strukturave menaxhuese pjesëmarrëse dhe këshilluese në institucionet arsimore, përfshirë Bordin e institucionit, Këshillin e Prindërve dhe Komisionin e Shëndetit, Sigurisë dhe Mjedisit në kopështet dhe shkollat.	2026–2028	Drejtoria Arsimit,	Administratoret e Njësive Administrative; Këshilli bashkiak; Kopështet; Prindërit	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	— Struktura menaxhuese në kopështet dhe shkolla aktive.
Ofrimi i shërbimit psikosocial në kopështet shtimi në stafin e psikologëve	2026–2028	Drejtoria Arsimit, Burimet Njerëzore,	Kopështet; OSHC	Transferime specifike - Fondi i pagave (buxheti vendor)	— Nr. i fëmijëve (vajza/djem; nga familjet në nevojë dhe grupet vulnerabel) të mbështetur me shërbim psikosocial.
Mbështetja e nxënësve nga familjet në nevojë	2026–2028	Drejtoria Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale	Shkollat, Njësitë Administrative, OJQ	Buxhet vendor + donacione + projekte sociale	— Nr. i fëmijëve në nevojë dhe me aftësi të kufizuar nga bashkia në kopështet.
Ofrimi i shërbimit të ushqimit për fëmijët në institucionet parashkollore	2026–2028	Drejtoria Arsimit	Operatorët e licencuar,	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar	— Numri i kopështeteve — Numri i kopështeteve me drekë

- Sigurimi i vakteve ditore të shëndetshme dhe të balancuara për fëmijët që ndjekin kopshtet publike dhe shërbimi ushqimor në institucionet e arsimit parashkollor -Sigurimi i objekteve të arsimit parashkollor, dezinfektimi, furnizimi me ujë dhe ujë, materiale pastrimi etj.			Ministria e Arsimit, Sportit (MAS)	specifike, Përfshirë në zerin "Shpenzime Korrente, Mallra dhe shërbime"	
Mirëmbajtja dhe përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës arsimore - Zbatimi i ndërhyrjeve mirëmbajtjes të planifikuara dhe emergjente për ruajtjen e funksionalitetit dhe sigurisë së ambienteve shkollore dhe parashkollore. -Shpenzime për mirëmbajtjen e aparateve teknike	2026–2028	Drejtoria Arsimit DPMOP;	Shkollat, kopshtet	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike përfshirë në zerin "Shpenzime Korrente, Mallra dhe shërbime"	— Sipërfaqe në m ² në shërbim që mirëmbahet.
Sigurimi i sistemeve funksionale të ngrohjes në institucionet arsimore parauniversitare - Instalimi, monitorimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të ngrohjes për të garantuar kushte komode në periudha të ftohta.	2026–2028	Drejtoria Arsimit, DPMOP	Operatorë të energjisë,	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Përfshirë në zerin "Shpenzime Korrente, Mallra dhe shërbime"	— Numri i shkollave që ngrohen me dru zjarri, arsimit bazë, — Numri i shkollave që ngrohen me kaldaja dhe naftë, arsimit bazë.
Sigurimi i objekteve për raste të ngjarjeve të jashtëzakonshme si zjarr dhe termete arsimit bazë dhe të mesëm (sigurimi i ndërtesës)	2026–2028	Drejtoria Arsimit		Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Përfshirë në zerin "Shpenzime Korrente, Mallra dhe shërbime" ¹	— Nr. i objekteve arsimore të siguruar
Furnizimi me dokumentacion administrativ për nevojat institucionale për institucionet e arsimit parauniversitar Prokurimi i regjistrave, formularëve dhe dokumenteve të tjera që mbështesin funksionimin administrativ të kopshteve.	2026–2028	Drejtoria Arsimit	Shkollat	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Përfshirë në zerin "Shpenzime Korrente, Mallra dhe shërbime"	— Nr. i kopshteve të pajisura me dokumentacion
Mbështetje për infrastrukturën dhe shërbimet mbështetëse (kancelari) - Mbështetja e procesit mësimor me mjete dhe materiale që ndihmojnë zhvillimin e kompetencave dhe aftësive të nxënësve.	2026–2028	Drejtoria Arsimit	Kopshtet MAS	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike, Përfshirë në zerin "Shpenzime Korrente, Mallra dhe shërbime" Donacione, prindërit	— Nr. i institucioneve të arsimit të pajisura me mjete didaktike
Investime për pajisje në godinat e shkollave të arsimit bazë dhe arsimit parashkollor. Blerje pajisje orëdi për Fëmijë që Frekuentojnë	Çdo vit 2026–2028	Drejtoria Arsimit, DPMOP	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike	— Nr. kopshteve të furnizuara me orëdi dhe pajisje

Kopshtet

Objektivi specifik O1.2. Krijimi i ambjenteve dhe mjediseve të sistemit arsimor bazë dhe parashkollor, të sigurtë konform standarteve ligjore.

Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Përgjegjës	Partnerë	Burimet financiare	Të dhëna dhe/ose Tregues
Investime në infrastrukturën e institucioneve të arsimit bazë dhe atë parashkollor: 1. Rikonstruksion Kopshti "Ton Alimhilli"	Çdo vit 2026–2028	Drejtoria Arsimit, DPMOP	Qeveria shqiptare Bashkia, donatorë	Buxhet vendor + transfertë e pakushtëzuar specifike	— Nr. i institucioneve arsimore parashkollore të rikonstruara, mirëmbajtura; — Nr. i institucioneve të arsimit bazë të rikonstruara, mirëmbajtura; — Përmirësim i kushteve në institucionet arsimore parashkollore dhe arsimit bazë: Kopshte në të cilat janë kryer punime kundrejt numrit total; — Sipërfaqe në m ² në shërbim të kopshteve/shkollave të arsimit bazë që mirëmbahet *(godina dhe ambjente shërbimi)

Monitorimi dhe vlerësimi

Zbatimi efektiv i Planit të Arsimit Parashkollor kërkon një sistem të qartë dhe të qëndrueshëm monitorimi dhe vlerësimi, që siguron ndjekjen sistematike të progresit dhe ofron bazën për përmirësime të vazhdueshme. Ky sistem është i lidhur ngushtë me objektivat dhe aktivitetet e planit të veprimit dhe mbështetet në të dhëna të verifikueshme, pjesëmarrje të aktorëve dhe transparencë institucionale.

Indikatorët e Performancës

Indikatorët e performancës janë të përqendruar në vlerësimin e rezultateve të arritura në raport me objektivat strategjikë. Ata janë të ndërlidhur me çdo kategori aktivitetsesh në planin e veprimit dhe do të përdoren për matjen e progresit të përvitshëm. Këta përfshijnë:

- Numrin e institucioneve të rikonstruara ose me kushte të përmirësuara;
- Numrin i kopshteve (hapësirave) të reja funksionale;
- Rritjen e regjistrimeve në kopshte dhe përfshirjen e fëmijëve nga grupe në nevojë;
- Numrin e mësuesve dhe edukatorëve të trajnuar;
- Cilësinë e mësimdhënies dhe përdorimin e mjeteve didaktike dhe teknologjisë;
- Numrin e aktiviteteve jashtëmësimore dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në to;
- Mbështetjen sociale për fëmijët në nevojë (ushqim, mjete, shërbime psiko-sociale);
- Eficienca në furnizim, mirëmbajtje dhe shërbime mbështetëse.

Planifikimi i vlerësimit të progresit

Progresi i planit do të vlerësohet përmes mekanizmave të strukturuar të raportimit dhe analizës, të cilët do të jenë të integruar në ciklin e planifikimit buxhetor dhe vendimmarrjes vendore. Vlerësimi do të përfshijë:

- Raportime vjetore mbi realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- Matjen e ndikimit të investimeve në infrastrukturë dhe cilësi shërbimi;
- Analizën e të dhënave të mbledhura përmes monitorimit në terren;
- Vlerësimin e përmirësimit të qasjes, përfshirjes dhe mjedisit të të nxënit;
- Ndërlidhjen e progresit me planifikimin e ardhshëm afatmesëm.

Përfshirja e aktorëve të jashtëm

Për të garantuar objektivitetin, transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm, do të sigurohet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm, si:

- Ekspertë të pavarur në fushën e arsimit, të ftuar për të kryer vlerësime tematike;
- Organizata joqeveritare që merren me cilësinë e arsimit dhe përfshirjen sociale;
- Këshillat e prindërve, drejtuesit e shkollave dhe komunitetet vendore;
- Njësitë e statistikës/performances dhe monitorimit të bashkisë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave;
- Partnerë ndërkombëtarë në kuadër të projekteve të mbështetura financiarisht.

Metodologjia e monitorimit dhe vlerësimi

Monitorimi i planit do të realizohet në dy drejtime kryesore:

1. **Monitorimi i nivelit të realizimit të aktiviteteve të planifikuara**
2. **Vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve në komunitetin arsimor**

Monitorimi i realizimit të aktiviteteve

Çdo aktivitet i planit do të vlerësohet në bazë të një sistemi pikëzimi nga 0 deri në 10, ku:

- **0** – Aktiviteti nuk ka nisur.
- **1–9** – Aktiviteti është pjesërisht i realizuar, në varësi të nivelit të zbatimit.
- **10** – Aktiviteti është realizuar plotësisht sipas planifikimit.

Për secilin objektiv strategjik të planit, do të përcaktohet numri total i pikëve maksimale, duke shumëzuar numrin e aktiviteteve të planifikuara për objektivin përkatës me 10 (p.sh., 5 aktivitete x 10 = 50 pikë maksimale për objektivin).

Gjatë zbatimit, pikët reale të arritura për çdo aktivitet do të regjistrohen, dhe më pas do të përmbledhen në nivel objektiv. Kjo do të mundësojë llogaritjen e përqindjes së realizimit të secilit objektiv në kohë reale:

Përqindja e realizimit të objektivit = (Pikë të realizuara / Pikë maksimale) × 100

Ky mekanizëm do të sigurojë një vlerësim të qartë, të matshëm dhe të krahasueshëm për zbatimin e planit përgjatë viteve.

Vlerësimi i ndikimit në komunitet

Për të matur ndikimin e aktiviteteve në komunitet, do të monitorohet shkalla e pjesëmarrjes së institucioneve arsimore dhe fëmijëve në zbatimin e tyre.

Për çdo aktivitet do të vendosen targete të matshme:

- Numri i kopshteve të synuara.
- Numri i fëmijëve të parashikuar për përfshirje (në kopsht dhe shkollë, sipas rastit).

Në përfundim të zbatimit të çdo aktiviteti, do të regjistrohet:

- Numri real i institucioneve që morën pjesë (në kopshte).
- Numri real i fëmijëve të përfshirë.

Në rastet kur aktiviteti synon vetëm një kategori (p.sh. vetëm kopshtet), pjesëmarrja për kategorinë tjetër do të konsiderohet.

Për çdo aktivitet do të llogaritet përqindja e pjesëmarrjes së arritur sipas formulës:

$$\text{Përqindja e pjesëmarrjes} = (\text{Numri real i pjesëmarrësve} / \text{Numri target}) \times 100$$

Ky tregues do të ndihmojë në vlerësimin e shkallës së përfshirjes dhe impaktit që ka pasur secili aktivitet në komunitetin arsimor.

Rishikimi dhe përshtatja e planit

Rishikimi dhe përshtatja e planit janë mekanizma thelbësorë për të siguruar vazhdimësinë, qëndrueshmërinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve të planifikuara në fushën e arsimit parashkollor në Bashkinë Shkodër. Këto procese shërbejnë për të ruajtur koherencën midis objektivave të planit, nevojave reale në terren dhe zhvillimeve të reja institucionale, ligjore apo sociale.

Procesi i rishikimit

Rishikimi i planit do të bëhet në mënyrë të strukturuar dhe të paracaktuar, me qëllim që të vlerësohet në mënyrë periodike efektiviteti i masave dhe aktiviteteve të ndërmarra. Planifikohen këto forma rishikimi:

- **Rishikimi vjetor** – i fokusuar në përditësimin e planit të veprimit dhe buxhetit vjetor në funksion të rezultateve dhe ndryshimeve të kontekstit;

- **Rishikimi afatmesëm (në fund të vitit 2027)** – për të analizuar realizimin e objektivave strategjike, performancën e indikatorëve dhe për të orientuar masat për vitin 2028;
- **Rishikime të jashtëzakonshme**, në rast të ndryshimeve madhore (si reformë e kuadrit ligjor, emergjenca, ndryshime buxhetore të rëndësishme).
Ky proces do të kryhet në mënyrë të ndërsektoriale, me pjesëmarrjen e drejtorive përgjegjëse, përfaqësuesve të institucioneve arsimore dhe aktorëve të tjerë vendorë.

Përshtatja e masave dhe aktiviteteve

Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga monitorimi dhe vlerësimi i planit, si dhe në konsultimet me komunitetin arsimor, do të ndërmerren përshtatje të nevojshme në:

- **Aktivitete konkrete** – duke përmirësuar përmbajtjen, kohëzgjatjen, mënyrën e zbatimit apo përgjegjësit;
- **Alokimin e burimeve** – në rast se disa fusha kërkojnë më shumë mbështetje për të arritur objektivat;
- **Prioritetet vjetore** – në përputhje me nevojat emergjente të fëmijëve, stafit arsimor apo komunitetit lokal;
- **Metodologjinë e zbatimit** – duke integruar praktikat më të mira dhe rekomandimet e vlerësimeve të jashtme.

Ky fleksibilitet në përshtatje synon të sigurojë që plani të mos mbetet një dokument statik, por të jetë një instrument dinamik, funksional dhe i orientuar drejt rezultateve reale për përmirësimin e arsimit parauniversitar në Bashkinë Shkodër.

Raportimi dhe transparenca

Zbatimi i Planit të Arsimit Parashkollor do të shoqërohet me mekanizma të qartë raportimi dhe transparenca, për të garantuar përgjegjshmëri institucionale dhe përfshirje qytetare në vlerësimin e progresit.

- **Raportimi i progresit** do të realizohet përmes raporteve periodike vjetore, të cilat do të përfshijnë ecurinë e zbatimit të objektivave, sfidat e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra nga njësitë përkatëse.
- **Përfshirja e publikut** do të sigurohet përmes publikimit të raporteve dhe rezultateve në faqen zyrtare të bashkisë, organizimit të takimeve konsultative me komunitetin dhe mundësimin të pjesëmarrjes qytetare në propozimin dhe vlerësimin e masave për përmirësimin e sistemit arsimor.

Kuadri Ligjor dhe nënligjor për Arsimin Parashkollor

Kuadri Kushtetues dhe Ligjor i përgjithshëm

- **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**, neni 57, pika 1
- **Ligji Nr. 139/2015**, “Për Vetëqeverisjen Vendorë”
- **Ligji Nr. 9936/2008**, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”

- **Ligji Nr. 68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”**
- **Ligji Nr. 9632/2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar**

Arsimi Parashkollor dhe i detyrueshëm (Bazë)

- **Udhëzim Nr. 25, datë 25.07.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”**
- **Urdhër nr. 199, datë 07.05.2024, “Për miratimin e Kornizës së vlerësimit të cilësisë së kopshtit”**
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MShMS nr. 20, datë 13.08.2025, “Për vitin shkollor 2025-2026 ne sistemin arsimor parauniversitar, neni 5 Arsimi parashkollor ”**

Përfshirja dhe mbrojtja e fëmijëve

- **Ligji Nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”**
- **Ligji Nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”**
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025**
- **Udhëzim Nr. 21, datë 08.08.2014, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkollor nga fëmijët romë”**
- **Udhëzim i përbashkët MAS–MShMS nr. 658, datë 23.09.2019, “Për mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dëmshme në internet**

Shërbimi psiko-Social dhe Përfshirja Sociale

- **Udhëzuesi për Praktikën e Punës së Shërbimit Psiko-Social Shkollor, për punonjësit e ZVA-ve dhe strukturat arsimore vendore.**

Vendim i Këshillit Bashkiak Nr.56 date 25.09.2025 “Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore. Akademia e trajtimit të njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”

Të dhëna për kopshtet publike

Kopshti	Emri Qytetit /Fshatit	Fshat/ Qytet	Me ushqim / Pa ushqim	Kapaciteti	Ne ndertesen e shkolles
“1 Qershori”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	30	Po
“Ngjyrat”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	120	Jo
“Ajasëm”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	20	Po
“Ali Laçej”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	50	Po
“Azem Hajdari”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	50	Po
“BepTusha”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	115	Jo
“Dëshmorët e Prishtinës	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	20	Po
“Feth Barbullushi	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	80	Jo
“Gjuhët e Huaja”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	30	Po
“Ismail Qemali”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	25	Po
“Ismet Sali Bruçaj”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	120	Jo
Liria”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	30	Po
“Njomëzat”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	100	Jo
“Ndoc Mazi”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	50	Po
“Pashko Vasa”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	50	Po
“Edith Durham”	Shkodër	Qytet	Me ushqim	80	Po
“Ruzhdi Daca”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	25	Jo
Shirokë	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	25	Po
“Ton Alimhilli”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	120	Jo
“Xixëllonjat”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	120	Jo
“Zija Buliqi”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	40	Jo
Zogaj	Shkodër	Qytet	PaUshqim	20	Po
Bardhaj	Bardhaj	Fshat	Pa Ushqim	50	Po
“Isa Jakupi”	Dobraç	Fshat	Pa Ushqim	60	Jo
“Haxhi Hajdari”	Golem	Fshat	Pa Ushqim	50	Jo
“Tring Smajli”	Grudë e Re	Fshat	Pa Ushqim	60	Po
Guci e Re	Guci e Re	Fshat	Pa Ushqim	30	Jo

Hot i Ri	Hot i Ri	Fshat	Pa Ushqim	20	Po
Shtoj i Ri	Shtoj i Ri	Fshat	Pa Ushqim	40	Jo
Shtoj i Vjetër	Shtoj i Vjetër	Fshat	Pa Ushqim	30	Po
Zues	Zues	Fshat	Pa Ushqim	20	Po
Elbacë	Elbacë	Fshat	Pa Ushqim	20	Po
Muriqan	Muriqan	Fshat	Pa Ushqim	30	Po
Oblikë	Oblikë	Fshat	Pa Ushqim	40	Jo
“Hasan Dardhanjori”	Oblikë	Fshat	Pa Ushqim	30	Po
“Frederik Gjon Gjoni”	Bërdicë e Madhe	Fshat	Pa Ushqim	25	Po
“Agim Tafili”	Bërdicë Sipërme	Fshat	Pa Ushqim	25	Po
Trush	Trush	Fshat	Pa Ushqim	75	Po
“Adem Haxhija”	Postribë	Fshat	Pa Ushqim	50	Po
Dragoç	Postribë	Fshat	Pa Ushqim	30	Po
Kullaj	Postribë	Fshat	Pa Ushqim	20	Po
Drisht	Drisht	Fshat	Pa Ushqim	20	Jo
Mes-Myselim	Mes	Fshat	Pa Ushqim	20	Po
“At Gjon Karma”	Gur i Zi	Fshat	Pa Ushqim	50	Po
Kuç	Kuç	Fshat	Pa Ushqim	20	Jo
Rrenc	Rrenc	Fshat	Pa Ushqim	25	Po
Vukatanë	Vukatanë	Fshat	Pa Ushqim	30	Po
Shirq	Shirq-Mushan	Fshat	Pa Ushqim	25	Po
“Nikollë Zogorjani”	Velipojë	Fshat	Pa Ushqim	25	Jo
Nj.A.Velipojë	Velipojë e Re	Fshat	Pa Ushqim	25	Jo
“Gjergj Vate Martini”	Velipojë e Re	Fshat	Pa ushqim	20	Po

Të dhëna për kopshtet jo publike

Kopshti	Emri i Qytetit/ Fshatit	Fshat/ Qytet	Me ushqim / Pa ushqim	Kapaciteti	Ne ndertesen e shkolles
“Aromë Trëndafili”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	180	Jo
“Cor Jesu”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	70	Po
“Maria Ndhimëtare”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	90	Po
Miqësia”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	50	Po
“Zemra e Krishtit”	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	70	Po
“Zemra e Gëzuar”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	55	Jo
“Nënë Françiska”	Hot i Ri	Fshat	Me Ushqim	65	Jo
“Delfinët”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	65	Jo
Pranvera	Shkodër	Qytet	Pa Ushqim	75	Jo
“Maarif Albania”	Shkodër	Qytet	Me Ushqim	60	Jo